



Polytechnic University of Tirana
Institute of Geosciences
Department of Meteorology



2024

**BULETINI MUJOR
KLIMATIK
CLIMATE MONTHLY
BULLETIN**

VOLUMI / VOLUME NR.8

NUMRI / ISSUE 94

TETOR / OCTOBER

ISSN: 2521-831X

www.geo.edu.al

TIRANA - ALBANIA

Scientific & Editorial Board

Prof.Dr. Petrit ZORBA – Chief Editor & Member of the Department of Meteorology, PUT – IGEO, Tirana, Albania.

Akad. Floran VILA – Academy of Sciences, Tirana, Albania.

Akad. Mimoza HAFIZI – Faculty of Natural Sciences, Tirana University, Albania.

Prof.Dr. Gjergj IKONOMI – “POLIS” University – Tirana, Albania.

Prof.assoc.Dr. Valbon BYTYCI – Prishtina University, Kosova.

Dr. Azem BARDHI – Head of the Department of Meteorology, PUT – IGEO, Tirana, Albania.

External Reviewers:

Ph.D. Sante LAVIOLA, – National Research Council of Italy (CNR), Institute of Atmospheric Sciences and Climate (ISAC), Bologna, Italy.

English Supervisor: Eng. Elsuida HOXHA, Grove School of Engineering, CCNY, NY, USA

The Editorial Advisory Board approved by the Director of IGEO –

Prof.Dr. Ylber MUCEKU

Ky buletin u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Meteorologjisë së IGJEO sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Meteorology of IGEO by rubrics as follows:

Data digitalization: M.Sc. Gentiana STAFA

Data control, verification & and elaboration under the supervision of: Prof.Dr. Petrit ZORBA done by: M.Sc. Gazmir ÇELA, Eng. Elsuida HOXHA and Eng. Anira GJONI.

Solar Radiation: Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA

Air temperatures: Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA and Eng. Anira GJONI.

Atmospheric precipitation: Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA

Scientific Article: G.ÇELA & P. ZORBA

The cover of this bulletin is composed and prepared by

Eng. M.Sc. Elsuida HOXHA

PËRMBAJTJA / CONTENTS

04	HYRJE INTRODUCTION
06	MOTI I HAPSIRËS SPACE WEATHER
08	RREZATIMI DIELLOR SOLAR RADIATION
10	TEMPERATURAT TEMPERATURES
14	RESHJET PRECIPITATION
20	AGROMETEOROLOGJI AGROMETEOLOGY
22	ARTIKULL SHKENCOR SCIENTIFIC PAPER
30	INFORMACION SHKENCOR SCIENTIFIC INFORMATION

Buletini Mujoꝛ Klimatik Nr. 94 - 2024 ndodhet i publikuar në faqen "on line" të OBM, UPT, IGEO dhe një sërë institucioneve të tjera. Për buletinet e tjera mund të klikoni në logot përkatëse, që ndodhen në vijim.

Monthly Climate Bulletin Nr. 94 - 2024 is published on the web site of WMO, PUT, IGEO and other institutions. For the other bulletins you can click on the respective logo, that are listed below.



HYRJE

Muaji tetor 2024 apo siç quhet ndryshe dhe vjeshtë e dytë u karakterizua nga një mot i qëndrueshëm në pjesën më të madhe të kohës, ku duhet theksuar se filloi me një situatë të mbizotëruar me fusha me presion të lartë atmosferik dhe u mbyll po me të njëjtat karakteristika siç ilustruhet dhe në figurën Nr.1 e Nr.2.

Paqëndrueshmëritë atmosferike relativisht të pakta ishin karakteristike më së shumti e gjysmës së parë të muajit, kur u vërtetuan dhe reshjet më të shumta, që gjithsesi patën një shpërndarje jo uniforme. Vlerat më të larta të reshjeve atmosferike u shënuan në pjesën veriore, ndërsa pjesa jugore u karakterizua me anomali negative. Përkundër kësaj situatë natyrisht edhe pse ditët vijuan të jenë gjithnjë e më të shkurta, që pas datës 22 shtator 2024 kur u vërtetua ekuinoksi i vjeshtës duhet thënë se u regjistrua një numër ditësh me diellëzim dhe temperatura të ajrit që ishin më të larta se vlerat e normës dhe u shoqëruan me anomali, të cilat në shkallë vendi vlerësohen në $+2.2^{\circ}\text{C}$.

Më të theksuara ishin anomali të e temperaturave maksimale të ajrit që shënuan vlerën $+3.3^{\circ}\text{C}$, ndërsa anomali të e vlerave minimale arritën deri në $+1.0^{\circ}\text{C}$. Sa i takon reshjeve ato shënuan një shmangie prej -37.3% kundrejt vlerave të normës ndërkohë që numri i ditëve me reshje ishte po ashtu nën vlerat e normës me po të njëjtën shmangie. Pjesa veriore e vendit pati më shumë reshje, të cilat arritën deri në nivelin e 200mm ndërsa pjesa jugore u karakterizua me reshje të pakta dhe në disa vendmatje nuk u shënuan asnjë ditë me reshje, sidomos në ekstremin jugor të Shqipërisë.

Në këtë buletin është përfshirë dhe një artikull shkencor mbi vlerësimin e reshjeve efektive në një hapësirë bujqësore të Shqipërisë si dhe një informacion shkencor mbi "Borën" një erë karakteristike dhe rajonale që vërtetohet në disa vende Ballkanike, që ligen nga deti Adriatik.

INTRODUCTION

The October 2024 period, also known as the second autumn, was marked by stable weather for most of the time. Notably, it began with high atmospheric pressure fields and ended with the same characteristics, as illustrated in Figures 1 and 2.

Relatively few atmospheric instabilities were characteristic mostly of the first half of the month, when the most abundant precipitation was observed, which in any case had a non-uniform distribution. The highest values of atmospheric precipitation were recorded in the northern part, while negative anomalies characterised the southern part. Despite this situation, of course, although the days continued to be increasingly shorter, after September 22, 2024, when the autumn equinox was observed, it must be said that some days with sunshine and air temperatures that were higher than the norm were recorded and were accompanied by anomalies, which on a national scale are estimated at $+2.2^{\circ}\text{C}$. The most pronounced were the anomalies of maximum air temperatures that marked the value of $+3.3^{\circ}\text{C}$, while the anomalies of minimum values reached up to $+1.0^{\circ}\text{C}$. As for precipitation, they marked a deviation of -37.3% compared to the norm values, while the number of days with precipitation was also below the norm values with the same deviation. The northern part of the country had more precipitation, which reached up to 200mm, while the southern part was characterised by low precipitation and in some stations, no days with precipitation were recorded, especially in the extreme south of Albania.

This bulletin also includes a scientific article on the assessment of effective rainfall in an agricultural area of Albania, as well as scientific information on "Bora", a characteristic and regional wind observed in several Balkan countries, which are to the east of the Adriatic Sea.

Figure Nr.1 – Situata sinoptike e datës
1 tetor 2024 në Europë.

Synoptic situation in Europe on date
October 1, 2024.





Figure Nr.2 – Situata sinoptike e datës
31 tetor 2024 në Europë.

Synoptic situation in Europe on date
October 31, 2024.



MOTI I HAPËSIRËS

Moti i hapësirës në ditët e sotme po merr gjithnjë e më shumë një rëndësi të veçantë, pasi ndikimet e tij po shfaqen në mjaft sektorë të ekonomisë në vende të ndryshme të globit.

Gjatë këtij muaji një shpërthim apo flakërim diellor i klasës X u vrojtu më 1 tetor 2024 duke u konsideruar si i dyti më i fuqishëm i Ciklit të 25 Diellor, i cili është paraqitur në figurën Nr.3.




Figure Nr.3 – Një flakërim diellor i klasës X7.1 i vërtetuar më datë 1 tetor 2024.
An X7.1-class solar flare on Oct. 1, 2024. Credit: NASA/SDO

Njolla diellore me emërtimin AR3842 sipas Observatorit të Dinamikave Diellore të NASA-s, emetoi një masë rrezatimi, e cila kur mbërriti në pjesën e sipërme të atmosferës së Tokës e jonizoi në nivele të larta atë, duke shkaktuar dhe përcjellë ndërprerje të transmetimeve në valë të shkurtra mbi Afrikë dhe pjesën Jugore të Atlantikut. Në frekuencat nën 30 MHz për më se një gjysmë ore u evidentua humbje e sinjalit pas orës 12:18 UTC.

Më datë 24 tetor gjithashtu pati një njollë diellore AR3869 që prodhoi një flakërim të kategorisë X3.3, ilustruar me pamjen e figurës Nr.4.




Figure Nr.4 – Një flakërim diellor i klasës X3.3 i vërtetuar më datë 24 tetor 2024.
An X3.3 class solar flare on Oct. 24, 2024. Credit: NASA/SDO

SPACE WEATHER

Space weather is becoming increasingly important these days, as its impacts are being felt in many sectors of the economy in different countries around the globe.

During this month, an X-class solar flare or explosion was observed on October 1, 2024, considered the second most powerful of the 25th Solar Cycle, which is shown in Figure No.3.

Sunspot named AR3842 according to NASA's Solar Dynamics Observatory, emitted a mass of radiation, which when it reached the upper part of the Earth's atmosphere ionised it at high levels, causing and following interruptions in shortwave transmissions over Africa and the South Atlantic. At frequencies below 30 MHz for more than half an hour, signal loss was evident after 12:18 UTC.

On October 24, there was also a sunspot AR3869 that produced an X3.3 category flare, illustrated by the appearance of image No.4.

Një pamje me emetimet e masës koronare të Diellit më datë 24 tetor 2024 paraqitet në figurën Nr.5, ku një komponente e tyre është e drejtuar e drejtim të Tokës dhe mund të arrijë më datë 26 tetor duke krijuar një stuhi gjeomagnetike të kategorisë G1.

A view of the Sun's coronal mass ejections on October 24, 2024, is shown in Figure No.5, where one of their components is directed towards Earth and could reach it on October 26, creating a G1 category geomagnetic storm.




Figure Nr.5 – Një emetim i masës koronare të Diellit e vërtetuar më datë 24 tetor 2024.
A bulk of this CME on date Oct. 24, 2024.

Një emetim tjetër nga Dielli u vërtetua më datë 29 tetor 2024. Masa në fjalë arriti deri në 500 mijë km mbi sipërfaqen jugperëndimore të Diellit, një distancë më e madhe se ajo nga Toka në Hënë, duke dëshmuar dhe një herë se aktualisht ndodhemi në periudhën e maksimumit të ciklit të 25 Diellor. Një situatë e tillë është ilustruar me pamjen e dhënë në figurën Nr.6.

Another emission from the Sun was observed on October 29, 2024. The mass in question reached up to 500 thousand km above the southwestern surface of the Sun, a distance greater than that from the Earth to the Moon, proving once again that we are currently in the period of the maximum of the 25th Solar Cycle. Such a situation is illustrated by the view given in Figure No. 6.



Figure Nr.6 – Një emetim masiv i Diellit më datë 29 tetor 2024.
A colossal Solar Prominence on Oct. 29, 2024.

RREZATIMI DIELLOR

Pas ekuinoksit të vjeshtës më 22 shtator 2024 në vendin tonë vijoi një rënie graduale e kohëzgjatjes së ditës për shkaqe të njohura astronomike dhe natyrisht kjo shoqërohet dhe me një rënie në vlerat e rrezatimit diellor të mbërritur deri pranë sipërfaqes. Në këtë kontekst për muajin tetor një rëndësi të veçantë mbi ecurinë e diellzimit apo treguesve të tjerë të rrezatimit diellor, merr mbulesa me re, pra vranësira, që është ilustruar dhe me një pamje skematike dhënë në figurën Nr.7.

Në kontekstin e një moti që vetëm në 3-4 ditë në shkallë vendi u shoqërua me vranësira më të theksuara dhe reshje, duhet thënë se në pjesën tjetër të kohës me pak ndryshime nga veriu në jug mbizotëroi mot i kthjellët dhe pa reshje duke ofruar ndërkohë mjaft orë me diell.

Vlerësimi i treguesit të rrezatimit diellor dhe diellzimit të përlogaritur nga të dhënat e disa vendmatjeve meteorologjike të Shqipërisë për muajin tetor 2024 janë paraqitur në figurat Nr.8 dhe Nr.9/a,b,c, për vendmatjet në Rapsh, Fier dhe në Belsh.

Figure Nr.8 - Rrezatimi diellor për muajin tetor 2024 për Shqipërinë. / Solar radiation for October 2024 for Albania (në / in W/m^2).

Vlerat të këtij treguesi më të ulta u shënuan në veri ku pati dhe më shumë vranësira dhe reshje.

The lowest values of this indicator were recorded in the north, where there was more cloudiness and precipitation.



After the autumn equinox on September 22, 2024, a gradual decrease in the day continues in our country for known astronomical reasons, and of course, this is also accompanied by a decrease in the values of solar radiation reaching the surface. In this context, for October, cloud cover, i.e. cloudiness, takes on a special importance over the progress of insolation or other indicators of solar radiation, which is illustrated with a schematic view given in Figure No. 7.

In the context of a weather that in only 3-4 days nationwide was accompanied by more pronounced cloudiness and precipitation, it must be said that in the rest of the time, with little change from north to south, clear weather prevailed without precipitation, offering in the meantime plenty of hours of sunshine.

The assessment of the solar radiation and sunshine indicator calculated from data of several meteorological stations in Albania for October 2024 is presented in Figures No.8 and No.9/a,b,c, for the measurement sites in Rapsh, Fier and Belsh.




Figure Nr.7 – Vranësirat luajnë një rol të madh në efektivitetin e paneleve diellore.

Cloud cover plays a major role in the effectiveness of solar panels.





Figure No.9/a,b,c – Ecuria ditore e treguesit të orëve me diell për vendmatjet meteorologjike të Rapshit, Belshit dhe Fierit për muajin tetor 2024.
Daily sunshine data for the meteorological stations of Rapsh, Belsh and Fier for October 2024.



TEMPERATURAT E AJRIT

Muaji tetor 2024 në shkallë globale, referuar të dhënave të ERA5 u karakterizua me një temperaturë $+0.8^{\circ}\text{C}$ më të lartë se mesatarja e periudhës 1991-2020, duke shënuar një temperaturë mesatare të ajrit pranë sipërfaqes së tokës në lartësinë 2 m me madhësi 15.25°C . Pas muajit tetor 2023 ai renditet si i dyti muaj më i ngrohtë. Në vijim në hartat e paraqitura në figurën Nr.10 dhe Nr.11 jepen të dhënat e temperaturave mesatare në shkallë globale dhe për Europën si dhe anomalitë e tyre për muajin tetor 2024. Për kontinentin European temperaturat mesatare të ajrit për këtë muaj shënuan vlerën 10.83°C , ose

AIR TEMPERATURES

October 2024 on a global scale, referring to ERA5 data, was characterised by a temperature of $+0.8^{\circ}\text{C}$ higher than the average of the 1991-2020 period, marking an average air temperature near the earth's surface at a height of 2 m with a magnitude of 15.25°C . After October 2023, it will rank as the second warmest month. The following maps presented in Figures No.10 and No.11 provide data on average temperatures on a global scale and for Europe as well as their anomalies for October 2024. For the European continent, the average air temperatures for this month marked the value of 10.83°C , or




Figure Nr.10 - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin tetor 2024 kundrejt periudhës 1991÷2020 në shkallë globale dhe për kontinentin European.
Surface air temperature anomaly in global scale and for the European continent for October 2024 compared to the period 1991÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc.).





Figura Nr.11. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin European për muajin tetor 2024, sipas NOAA-s.
Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of October 2024, according to NOAA.

+1.23°C më të lartë se vlera e normës referuar periudhës 1991-2020. Ky muaj përlllogaritet si i pesti në renditje si muaji i ngrohtë dhe -0.68°C më i freskët se muaji tetor 2022, që ka shënuar dhe muajin më të ngrohtë.

Me këtë ecuri të deritanishme të temperaturave të ajrit muaj pas muaji duket më se e pritshme që viti 2024 të shënoi një rekord. Në këtë këndvështrim në vijim në figurën Nr.12 paraqitet një vlerësim paraprak mbi ecurinë e temperaturave vjetore të ajrit në shkallë globale.

+1.23°C higher than the norm value referred to the period 1991-2020. This month is calculated as the fifth warmest month and -0.68°C cooler than October 2022, which has also marked the warmest month.

With this performance of air temperatures month after month so far, it seems more than expected that the year 2024 will mark a record. In this perspective, the following figure No.12 presents a preliminary assessment of the performance of annual air temperatures on a global scale.



Sa i takon Shqipërisë nga përpunimi i të dhënave të përfthuara nga vendmatjet meteorologjike rezultojnë një sërë temperaturash të ajrit që janë karakterizuar me vlera të larta dhe natyrisht me anomali pozitive kundrejt periudhës shumëvjeçare 1961-1990. Në vijim në figurën Nr.13/1-8 paraqiten grafikisht ecuritë e temperaturave maksimale e minimale ditore të ajrit për një


As for Albania, the processing of data obtained from meteorological stations results in a series of air temperatures that are characterised by high values and of course, positive anomalies compared to the multi-year period 1961-1990. The following figure No.13/1-8 graphically presents the trends of maximum and minimum daily air temperatures for a series of meteorolo-

sërë vendmatjesh meteorologjike që i përkasin zonave dhe nënzonave të ndryshme klimatike të vendit.

-gical measurement sites belonging to the country's various climatic zones and subzones.

Figure Nr.13/1÷8 - Temperaturat dhe reshjet ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin tetor 2024 në Shqipëri.

The daily temperatures and precipitation for some meteorological stations for October 2024 in Albania.



Temperaturat mesatare të ajrit në shkallë vendi u karakterizuan nga një anomali prej +2.2°C, ndërsa vlerat maksimale dhe minimale përkatësit me +3.3°C dhe +1.0°C.


Në figurat Nr.14, Nr.15 dhe Nr.16 janë paraqitur grafikisht të dhënat e temperaturës mesatare të ajrit, si dhe ato maksimale e minimale së bashku me vlerat përkatëse të normës referuar periudhës 1961-1990 për muajin tetor 2024 për disa

The average air temperatures at the national level were characterised by an anomaly of +2.2°C, while the maximum and minimum values corresponded to +3.3°C and +1.0°C.

Figures No.14, No.15 and No.16 graphically present the average air temperature data, as well as the maximum and minimum ones, together with the corresponding values of the norm referred to the period 1961-1990 for the month of

vendmatje meteorologjike të përzgjedhura nga ato të analizuar dhe përpunuara për këtë qëllim.

October 2024 for several sites selected from those analysed and processed for this purpose.



Figurë Nr.14. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit tetor 2024 për Shqipërinë.

Values of mean air temperatures for some meteorological stations of October 2024 for Albania.




Figure Nr.15. - Vlerat e temperaturave mesatare maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit tetor 2024 për Shqipërinë.

The values of mean maximal air temperatures for some meteorological stations of October 2024 for Albania.




Figure Nr.16. - Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit tetor 2024 për Shqipërinë.

The values of absolute maximal air temperatures for some meteorological stations of October 2024 for Albania.

RESHJET ATMOSFERIKE

Muaji tetor 2024 u karakterizua me reshje në pjesën perëndimore të kontinentit European, ndërkohë që në pjesën qendrore dhe në atë lindore reshjet ishin nën vlerat e normës. Një paraqitje më e detajuar për shpërndarjen në hapësirë për Europën për reshjet dhe anomalitë e tyre të shprehura në % mundësohet nëpërmjet hartave të dhëna në vijim në figurën Nr.17.

Sa i takon vendit tonë situata paraqitet me ndryshueshmëri nga veriu në jug të vendit, ku nëse pjesa veriore është karakterizuar me më shumë reshje atmosferike, gradualisht drejt jugut shënohen vlera në rënie dhe anomali negative.




Figura Nr.17. - Reshjet për muajin tetor 2024 në kontinentin European dhe anomalitë kundrejt periudhës 1991÷2020, sipas NOAA-s.

Rainfall for October 2024 at the European continent and their anomalies referring to the period 1991÷2020 according to NOAA.

Gjithsesi në tërësinë e tyre reshjet atmosferike për Shqipërinë për muajin tetor 2024 ishin nën vlerat e normës, të cilat mesatarisht në shkallë vendi arritën deri në 62.7%. Në paraqitjen grafike të dhënë në figurën Nr.18 dukshëm evidentohet kjo anomali negative për pjesën më të madhe të vendmatjeve meteorologjike të analizuara. Në të njëjtën ecure paraqitet dhe treguesi i numrit të ditëve me reshje, i cili paraqitet grafikisht në figurën Nr.19 ku nuk u shënuan më shumë se 2/3 e vlerave të ditëve me reshje sipas normës 1961-1990.

October 2024 was characterised by precipitation in the western part of the European continent, while in the central and eastern parts, precipitation was below normal values. A more detailed presentation of the spatial distribution of precipitation and its anomalies expressed in % for Europe is provided by the maps given below in Figure No.17.

As for our country, the situation is presented differently from north to south of the country, where if the northern part is characterised by more precipitation, gradually decreasing values and negative anomalies are recorded towards the south.

However, in their entirety, the precipitation for Albania for October 2024 was below the norm values, which, on average, at the national level reached up to 62.7%. In the graphic presentation given in Figure No.18, this negative anomaly is evidenced for most of the analysed meteorological stations. The rainy days' index also appears in the same trend, which is graphically presented in Figure No.19, where no more than 2/3 of the values of days with precipitation according to the 1961-1990 norm were recorded.




Figura Nr.18. - Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajin tetor 2024 për Shqipërinë.

The level of precipitations for some meteorological stations of October 2024 for Albania.




Figure Nr.19 - Numri i ditëve me reshje >1.0 mm gjatë muajit tetor 2024 në Shqipëri.

The rainy days number >1.0 mm during October 2024 in Albania.




Figure Nr.20. - Lartësia e reshjeve maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike të muajit tetor 2024 për Shqipërinë.

The amount of maximal 24 hours of precipitations for some meteorological stations of October 2024 for Albania.

Sa i takon intensiteteteve maksimale të reshjeve atmosferike 24 orëshe për një sërë vendmatjesh meteorologjike ato janë paraqitur grafikisht në Figurën Nr.20. Në vijim trajtohen dhe disa situata të veçanta meteorologjike të këtij muaji për territorin e Shqipërisë, të ilustruara me pamjet e dhëna në figurat Nr.21,22 dhe 23.

Regarding the maximum 24-hour precipitation intensities for a series of meteorological measurement sites, they are graphically presented in Figure No.20. The following discusses some special meteorological situations of this month for the territory of Albania, illustrated with the images given in figures No. 21, 22 and 23.




Figure Nr.21 – Pamje nga qielli mbi Tiranë më datë 1 tetor 2024 në orën 13:18(a) dhe 18:01 (b), ku qartë dallohet dukuria e kondensimit nga gazrat e prodhuara nga djegiet e karburantit të avionëve (b), të cilat kur dalin ndeshen në atmosferë me temperatura më të ulta dhe krijojnë re të tipit “contrails”. Ato përgjithësisht nuk qëndrojnë më shumë se disa sekonda ose deri në pak minuta, të dukshme me sy të lirë.

View from the sky over Tirana on October 1, 2024 at 13:18 (a) and 18:01 (b), where the phenomenon of condensation from gases produced by the combustion of aircraft fuel (b) is clearly visible, which when they emerge encounter lower temperatures in the atmosphere and create "contrails" type clouds. They generally do not last more than a few seconds or up to a few minutes, visible to the naked eye. (photo © by P. Zorba)



Figure Nr.22 – Prania e mbulesës me re mbi Tiranë më datë 3.10.2024 ora 08:02 AM.
The presence of cloud cover over Tirana on 3.10.2024 at 08:02 AM.

Më datë 3 tetor 2024 një paqëndrueshmëri atmosferike mbizotëroi në mbarë vendin me shtim gradual të reve të ulta ilustruar me pamjen e figurës Nr.22 me mbizotërim në pjesën më të madhe të vendit si dhe natyrisht të reshjeve atmosferike. Reshjet në zona të caktuara krijuan dhe situata përmbytjesh të kufizuara siç ilustrohet dhe me pamjet e figurës Nr.22.

On October 3, 2024, an atmospheric instability prevailed throughout the country with a gradual increase in low clouds, illustrated by the appearance of Figure No.22, with a predominance in most of the country, as well as, of course, atmospheric precipitation. Precipitation in certain areas also created limited flooding situations, as illustrated by the appearance of Figure No.22.



Figure Nr.23- Pamje TV nga përmbytjet për zonat nga Lezha në Vlorë më datë 4 tetor 2024.

TV footage of the floods in the areas from Lezha to Vlorë on October 4, 2024.



Figure Nr.24 - Pamje të qiellit mbi Tiranë më datë 17.10.2024 ora 15:24 (a); datë 20.10.2024 ora 10:46 (b), si dhe pamje nga TV me informacione mbi virozat e shtuara, më datë 20 tetor 2024 (c).

Sky views over Tirana on 17.10.2024 at 15:24 (a); 20.10.2024 at 10:46 (b), as well as TV footage with information on the added viruses, on 20 October 2024 (c).



Ndërkohë, duhet theksuar se atmosfera dhe përbërja e saj është vazhdimisht në ndikimin e ndotëseve të ndryshëm që vijnë nga burime të ndryshme. Një ndër to është dhe aviacioni, i cili përlllogarit në ditët e sotme mbi 120 mijë fluturime në ditë.


Pamjet e dhëna në figurën Nr.24 (a) dhe (b) janë të ndryshme nga ato të figurës Nr.21 (b), ku qartë dallohet se nuk kemi të bëjmë thjesht me retë e tipit “contrails”, pasi masat e kondensuara qëndrojnë shumë më gjatë në atmosferë duke krijuar një hijëzim të atmosferës, i cili natyrisht siç e kemi theksuar dhe në numra të tjerë të mëparshëm të këtij buletini ndikojnë në uljen e performancës së sistemeve fotovoltaike e po ashtu ngelet për tu vlerësuar e monitoruar se si e sa nanogrimcat që janë pjesë të tyre; çfarë përbërje kanë dhe sa të rrezikshme mund të jenë për shëndetin. Gjithsesi fakt është se në mjaft raste pas situatave të tilla një situatë përkeqësuar në shëndetin e popullatës vihet re, siç kjo ilustrohet dhe në figurën Nr.24 (c). Gjithashtu pa u zgjeruar shumë në këtë tematikë duket theksuar se në atmosferë

Meanwhile, it should be noted that the atmosphere and its composition are constantly under the influence of various pollutants coming from various sources. One of them is aviation, which currently accounts for over 120 thousand flights per day.

The images given in Figure No.24 (a) and (b) are different from those in Figure No.21 (b), where it is evident that we are not simply dealing with “contrails” type clouds, as the condensed masses stay much longer in the atmosphere, creating a shadowing of the atmosphere, which of course, as we have emphasized in previous issues of this bulletin, affects the reduction of the performance of photo-voltaic systems, and it also remains to be evaluated and monitored how nanoparticles that are part of them; what their composition is and how dangerous they can be to health. However, the fact is that in many cases, after such situations, a worsening of the health of the population is observed, as illustrated in Figure No.24 (c). Also, without expanding too much on this topic, it seems to be emphasised that in the

nga aviacioni për 2024 përlogariten të digjen rreth 10 mijë Kg lëndë djegëse karburante për çdo km².

atmosphere, aviation is estimated to burn about 10 thousand kg of fossil fuels per km² by 2024.



Situata sinoptike për datën 4 tetor 2024 e paraqitur ne hartën e dhënë në figurën Nr.25 ilustron mjaft qartë një situatë paqëndrueshmërie atmosferike pranë vendit tonë, e cila u shoqërua dhe me reshje në mbarë territorin.

The synoptic situation for October 4, 2024, presented on the map given in Figure No.25, clearly illustrates a situation of atmospheric instability near our country, which was also accompanied by precipitation throughout the territory.

Bazuar në të dhënat e reshjeve të pritshme të vlerësuara sipas modelit Aladin nga Sistemi i Udhëzimit për Përmbytjet e Menjëhershme të Europës Juglindore (SEEFFGS) në figurën Nr.27 paraqiten hartat ditore referuar orës 07:00 AM me parashikimin e reshjeve atmosferike për 24 në vijim për çdo ditë të muajit tetor 2024.

Based on the expected precipitation data estimated according to the Aladin model from the Southeast European Flash Flood Guidance System (SEEFFGS), Figure No.27 presents daily maps referenced to 07:00 AM with the forecast of atmospheric precipitation for the next 24 hours for each day of October 2024.

Siç evidentohet dhe nga vrojtimet meteorologjike reshjet në Shqipëri gjatë muajit tetor 2024 u vrotuan kryesisht në gjysmën e parë të muajit dhe në vlera më të larta në pjesën veriore të vendit.


As evidenced by meteorological observations, precipitation in Albania during October 2024 was observed mainly in the first half of the month and higher values in the northern part of the country.

Për këtë buletin vlen të theksohet në kuadrin e dukurive ekstreme të motit dhe përmbytja e vrotuar në Valencia të Spanjës në fund të muajit, ku u shënuan rreth 200 të vdekur e mjaft humbje ekonomike; që është ilustruar me pamjen e dhënë në figurën Nr.26.

For this bulletin, it is worth highlighting in the context of extreme weather phenomena the flooding observed in Valencia, Spain, at

the end of the month, where around 200 deaths and considerable economic losses were recorded, which is illustrated by the image given in Figure No.26.





AGROMETEOROLOGJI

Gjatë këtij muaji tetor shumica e bimëve të kultivuara dhe e vegjetacionit në tërësi ju drejtua fazave të fundit të jetës për këtë vit ku proceset fiziologjike shkuan gradualisht drejt rënies së ritmit. Gjithsesi ashtu si dhe në vitet e fundit në vendin tonë është shënuar një mbarrim më i vonë i periudhës së vegjetacionit; ndaj duhet theksuar se ky muaj me karakteristikat agrometeorologjike që pati duhet thënë se ishte mjaft favorizues për kulturat e dyta apo për ato me cikël të gjatë duke ndikuar për të marrë prodhime të larta për njësi sipërfaqe pasi si treguesit e shumës së temperaturave aktive mbi pragu 10°C (figurë Nr.29) ashtu dhe RAF (figure Nr.30) nuk munguan, ndërkohë që sa i takon lagështisë në këto faza përgjithësisht nga bimësia kërkesat janë më të kufizuara. Kjo situatë pozitive në tërësi evidentohet dhe nga vlerat e treguesit të vegjetacionit NDVI, i cili sipas javëve është paraqitur për Shqipërinë në figurën Nr.28.

AGROMETEOROLOGY

Throughout the October month in the majority of cultivated plants and vegetation in general, the physiological process gradually moved towards a decrease in rhythm. However, as in recent years, a later end to the vegetation period has been marked in our country; therefore, it should be noted that agrometeorological characteristics that were quite favourable for second crops or those with a long cycle, influenced for a production of high yields for a surface unit, since both the characteristics of the sum of active temperatures above the 10°C (figure No.29) threshold and the PAR potential (figure No.30) provided good condition.

Regarding humidity in this stage, the plant's requirements are at the minimum levels. This positive situation is also evidenced by the values of the NDVI vegetation records, and according to the week it is presented for Albania in Figure No.28.




Figure Nr.28 - Treguesi i vegjetacionit NDVI për muajin tetor 2024.
Vegetation Index NDVI for October 2024.

Figure Nr.29 – Vlerat e treguesit të shumës së temperaturave aktive mbi pragu 10°C për disa vendmatje meteorologjike të muajit tetor 2024 për Shqipërinë. The values of the indicator for the sum of the active temperatures above the threshold of 10°C for some meteorological stations in October 2024 for Albania.





Figure Nr.30 - Rrezatimi Aktiv Fotosintetik (RAF) për muajin tetor 2024
për Shqipërinë.
Photosynthetic Active Radiation (PAR) for October 2024 for Albania.



Agricultural assessment of effective rainfall in the Myzeqe Plain in the context of two climate norms

PhD (c) Gazmir ÇELA^a, Prof.Dr. Petrit ZORBA^a

^a Department of Meteorology, Institute of Geosciences, Polytechnic University of Tirana, Tirana, Albania

Email: gazmircela11@gmail.com, petrit.zorba@gmail.com

Abstrakt

Reshjet efektive janë ajo pjesë e reshjeve totale të shiut në një periudhë të caktuar, e cila është e dobishme për bimësinë, duke përjashtuar humbjet nga avullimi dhe rrjedhjet sipërfaqësore. Me anë të këtij studimi synohet të vlerësohen reshjet efektive për periudhën 1961–2020 në Fushën e Myzeqesë, një nga zonat më të rëndësishme bujqësore të Shqipërisë. Metodologjia e përdorur i takon marrjes në konsideratë vetëm të elementit të reshjeve bazuar në qasje empirike e përshkruar në “Dry Climate”. Për të arritur rezultate sa më praktike dhe të besueshme, të cilat përshtaten me tiparet klimatike të Shqipërisë, ku në stinën e verës reshjet janë të rralla dhe temperaturat e larta, ndërsa në dimër reshjet janë më të shpeshta, reshjet efektive janë llogaritur me prag 3 dhe 10 ditor. Kjo qasje e dy anshme e vlerësimit të agrometeorologjik të Fushës së Myzeqesë, mundëson vlerësimin klimatik në stinën e pranverës, periudhë me rëndësi për bimësinë, po ashtu në stinën e verës, kur thatësitrat bujqësore janë më të shpeshta. Rezultatet tregojnë se reshjet efektive variojnë ndjeshëm sipas sezonit dhe vitit, me një prirje të lehtë në ulje gjatë dekadave të fundit, veçanërisht në stinën e verës. Këto ndryshime lidhen ngushtë me rritjen e temperaturave dhe intensifikimin e thatësirave. Studimi nënvizon rëndësinë e integritetit të reshjeve efektive në planifikimin e menaxhimit të ujit dhe përdorimit racional të burimeve ujore për bujqësinë në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

Abstract

Effective precipitation refers to the portion of total rainfall during a given period that is beneficial for vegetation, excluding losses due to evaporation and surface runoff. This study aims to assess effective precipitation for the period 1961–2020 in the Myzeqe Plain, one of Albania's most important agricultural regions. The applied methodology considers only the rainfall component based on an empirical approach described in “Dry Climate.” To obtain practical and reliable results that align with the climatic characteristics of Albania—where summer is marked by scarce rainfall and high temperatures, and winter by more frequent precipitation—effective precipitation was calculated using both 3-day and 10-day thresholds. This two-fold agrometeorological assessment of the Myzeqe Plain allows for climate evaluation during the spring season, a critical period for vegetation, as well as during the summer, when agricultural droughts are more common. The results show that effective precipitation varies significantly by season and year, with a slight downward trend over recent decades, particularly in the summer season. These changes are closely linked to rising temperatures and the intensification of drought conditions. This study highlights the importance of integrating effective precipitation into water management planning and the rational use of water resources for agriculture in the context of climate change.

Keywords: Effective Precipitation, Agrometeorology, Drought, Myzeqe Field

Introduction

